



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 19.3.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Enver Hoti, Salih Salihu.

Munguan : Sërgjan Mitroviq, Liburn Aliu, Driton Çausi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen (intervistimin) e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Intervistimi i kandidatëve për drejtor Agjencie të Komplekseve Memoriale të Kosovës

Daut Haradinaj, kryetar, fillimisht përshëndeti komisionin dhe hapi diskutimin rreth çështjes së mirëvajtjes së intervistimit, ndaj **komisioni u pajtua** që kandidatët të pyeten jo domosdo nga të gjithë anëtarët, por kryetari të përshëndet kandidatin dhe të kërkojë nga ai të njoftojë shkurtimisht për biografinë e tij dhe arsyen e konkurrimit, pastaj të vazhdojë intervistimi edhe nga dy apo tre anëtarë të tjerë të komisionit.

Para se të fillojë intervistimi, komisioni sipas ftesës nga shërbimi i protokollit, sugjeroi tre deputetë për vizitën që do të bëhet në Beograd prej 12 deri më 14 prill 2018, Salih Salihu, Ganimete Musliu dhe Danush Ademi, por ndërkohë dy deputetët, Danush Ademi dhe Salih Salihu, njoftuan se nuk është e sigurt ardhja e tyre, prandaj nesër komisioni do të bëjë plotësimin eventual. Pasi që kërkohet edhe një anëtar nga stafi, sipas rregullave interne që vepron me stafin, Bajram Badivuku-koordinator, do të udhëtojë me këtë delegacion në Beograd.

Në vazhdim, komisioni intervistoi kandidatët : **Driton Mulaj, Bajram Xheladini, Bedri Gashi, Milazim Hajredini, Shahadije Shaqiri, Arsim Kajtazi, Bedri Salihu Adnan Elshani dhe Florim Shala.**

Nga të ftuarit për sot, munguan dy kandidatë, Elhami Qeriqi dhe Behxhet Rukiqi.

Pasi që nesër parashihet përfundimi i intervistimit, më 20.3.2018, Komisioni më pas do të mbledhet nesër dhe do të kryej procedimin përfundimtar me ç'rast do të propozojë dy kandidatët për mbledhjen plenare.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj